



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit/Glllogocit
Zyra e Kryetarit



Nr.01- 4621 01- 53377 dt. 19/12 /2025

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 72, pika h e Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 13 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 6 të Rregullores Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Zyra e Kryetarit nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për publikimin e Listës së Përgjithshme të pronave të Komunës së Drenasit, si dhe Listës së Veçantë të Pronave të Paluajtshme të Komunës së Drenasit që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2026.

Neni 1

Me këtë vendim publikohet Lista e Përgjithshme e Pronave të Komunës së Drenasit e paraqitur në formë tabelare.

Neni 2

Pjesë e këtij vendimi është dhe Lista e Veçantë e Pronave të Paluajtshme të Komunës së Drenasit që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2026, e cila përfshin të dhënat kadastrale të pronave, lokacionin dhe destinimin e tyre me PZHK dhe Hartë Zonale.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Vendimi i'u dërgohet:

-Zyrës së Kryetarit
-Drejtoria Përkatëse
-Arkivit



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

A r s y e t i m

Komuna e Drenasit duke u bazuar në faktin se me dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës do të krijohen kushte për zhvillimin e bizneseve, krijimin e mundësisë për investime nga investorët vendor dhe të huaj me ç'rast do të krijohen vende të reja të punës, dhe do të ndikohet në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunë.

Me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim sipas dispozitave ligjore në fuqi, Komuna do të inkason edhe të hyra komunale të cilat konsiderohen para publike dhe i nënshtrohen dispozitave ligjore për menaxhimin e financave publike.

Po ashtu Kuvendi i Komunës së Glllogocit me datë 30.07.2020, ka miratuar Vendimin për Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028, me të cilin është planifikuar zhvillimi ekonomik i Komunës së Glllogocit, ku pjesë e këtij plani janë edhe pronat të cilat janë pjesë e Listës së Veçantë që planifikohen të ipen në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2024.

Komuna e Glllogocit gjithashtu me datë 28.07.2022 ka miratuar edhe Hartat Zonale të Komunës së Glllogocit për vitin 2022-2030.

Baza juridike për t'i publikuar këtë listë është, neni 13 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe neni 6 i Rregullores Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Bashkangjitur me këtë vendim i gjeni:

- Listën e përgjithshme të pronave të Komunës së Glllogocit;*
- Listën e Veçantë të Pronave që Planifikohen për t'u dhënë në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2026;*
- Skicat e parcelave të cilat janë pjesë e listës së veçantë.*